



BASHKIA
TIRANË

R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

[Dt.07.01.2022]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “COMMUNICATION PROGRESS” shpk

Adresa: Tirane Rr. "Stanislav Zuber", Nd. 2, H.I9. Njesia administrative Nr. 7, 1023, Tirane.

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Mirëmbajtje e Sistemit të Vlerësimit të Performancës”** me Nr REF-14636-12-09-2021 për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 179 datë 13 Dhjetor 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1 Operatori ekonomik ”SOFT & SOLUTION” SHPK

NUIS L11328009F

Vlera e ofertës pa tvsh = **1.400.000** (një milion e katërqind mijë) lekë.

2 Operatori ekonomik "iCom" shpk

NUIS: L12402023H

Vlera e ofertës pa tvsh = **0** (ZERO) lekë

2 Operatori ekonomik "COMMUNICATION PROGRESS" shpk

NUIS: K01625001C

Vlera e ofertës pa TVSH– 1.368.000 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1 Operatori ekonomik "SOFT & SOLUTION" SHPK

NUIS L11328009F

Për arsyet e mëposhtme:

- Autoriteti Kontraktor, në pikën 2."Kriteret e veçanta të kualifikimit" të dokumenteve standarde të tenderit, përcakton se ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Operatori ekonomik "Soft & Solution" nuk ka paraqitur në spe sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3, duke mos përmbushur kështu kriterin 1/b të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit.

- Pjesë e kritereve të veçanta të kualifikimit, është kërkesa sipas pikës "2.3.1 të Kapacitetit teknik dhe profesional:

"2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara."

Operatori ekonomik, referuar këtij kriteri, ka paraqitur kontratë të ngjashme të realizuar me sektorin publik, vërtetim realizimi, por nuk ka paraqitur fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Sa më sipër, operatori ekonomik “Soft & Solution” nuk përmbush kriterin 2.3.1 të Kapacitetit teknik dhe profesional.

- Pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit, është kërkesa sipas pikës “2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

“2.3.3 Për të provuar se operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të ketë një personel teknik të diplomuar në një nga degët informatikë, elektronikë, telekomunikacion, informatikë-ekonomike apo të ngjashme me to, që do të angazhohet në zbatimin e kontratës, me këto kompetenca/ certifikata:

- a. 1 (një) punonjës të certifikuar si Auditor për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001.*
- b. 1 (një) punonjës të certifikuar për analizë softëare.*
- c. 1 (një) punonjës të certifikuar për mbështetjen e kontratës sipas praktikave të ITIL ose ekuivalente.*
- d. 2 (dy) punonjës të certifikuar për platformën softëare që ka në përdorim autoriteti kontraktor ose ekuivalente.*
- e. 1 (një) punonjës të certifikuar për testim softëare.*
- f. 1 (një) punonjës të certifikuar për administrim database.*
- g. 1 (një) punonjës të certifikuar për siguri në rrjet.*

Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomat ose vërtetime nga universitetet përkatëse.*
- Certifikata përkatëse*
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B;*
- Listëpagesat sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B.*

Operatori ekonomik “Soft & Solution” nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përmbushjen e kriterit 2.3.3/a “1 (një) punonjës të certifikuar si Auditor për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001”.

Operatori ekonomik “Soft & Solution” nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për

përbushjen e kriterit 2.3.3/d “2 (dy) punonjës të certifikuar për platformën softëare që ka në përdorim autoriteti kontraktor ose ekuivalente ”.

- Pjesë e dokumenteve standarde të tenderit, është Shtojca 2 sipas të cilës Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e cmimeve të shërbimeve:

Operatori ekonomik “Soft & Solution” nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përbushjen e shtojcës 2 pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.

KVO konstaton se operatori ekonomik “Soft&Solution” nuk ka përbushur kriterin 1/b , kriterin 2.3.3 pika a dhe d të kapacitetit teknik dhe profesional si pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit dhe shtojcën 2 pjesë e dokumenteve standarde të tenderit

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2 Operatori ekonomik ”iCom” shpk

NUIS: L12402023H

Për arsyet e mëposhtme:

- Pjesë e dokumenteve standarde të tenderit, është Shtojca 1 në të cilën përcakton se ofertuesi duhet të paraqesë formularin e ofertës.

Operatori ekonomik “iCom” sh.p.k nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përbushjen e shtojcës 1 pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.

- Pjesë e dokumenteve standarde të tenderit, është Shtojca 2 në të cilën përcakton se ofertuesi duhet të paraqesë listën e cmimeve të shërbimeve:

Operatori ekonomik “iCom” sh.p.k nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përbushjen e shtojcës 2 pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.

- Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.”Kriteret e veçanta të kualifikimit” të dokumenteve standarde të tenderit, përcakton se ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Operatori ekonomik “iCom” sh.p.k nuk ka paraqitur në spe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9 për përbushjen e kriterit 2/a.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Operatori ekonomik “iCom” sh.p.k nuk ka paraqitur në spe sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3, duke mos përmbushur kështu kriterin 1/b të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

- Pjesë e kriterëve të veçanta të kualifikimit, është kërkesa sipas pikës “2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Operatori ekonomik “iCom” sh.p.k nuk ka paraqitur në spe deklaratën se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit sipas Shtojcës 9, duke mos përmbushur kështu kriterin 2.1 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

- Pjesë e kriterëve të veçanta të kualifikimit, janë kërkesat sipas pikës “2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

“2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare në një vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar e kontratës që prokurohet lëshuar nga autoriteti përkatës. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur edhe nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

Operatori ekonomik “iCom” sh.p.k nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përmbushjen e kriterit 2.2.1.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Operatori ekonomik “iCom” sh.p.k nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përmbushjen e kriterit 2.2.2.

- Pjesë e kriterëve të veçanta të kualifikimit, është kërkesa sipas pikës “2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional” referuar së cilës kërkohet:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Operatori ekonomik “iCom” sh.p.k nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përmbushjen e kriterit 2.3.1.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

a) ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë;

b) ISO 20000-1 për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit;

c) ISO 27001 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit;

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën/çertifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Operatori ekonomik “iCom” sh.p.k nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përmbushjen e kriterit 2.3.2.

2.3.3 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe manaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të ketë një personel teknik të diplomuar në një nga degët informatikë, elektronikë, telekomunikacion, informatikë-ekonomike apo të ngjashme me to, që do të angazhohet në zbatimin e kontratës, me këto kompetenca/ certifikata:

a. 1 (një) punonjës të certifikuar si Auditor për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001.

b. 1 (një) punonjës të certifikuar për analizë softëare.

c. 1 (një) punonjës të certifikuar për mbështetjen e kontratës sipas praktikave të ITIL ose ekuivalente.

d. 2 (dy) punonjës të certifikuar për platformën software që ka në përdorim autoriteti kontraktor ose ekuivalente.

e. 1 (një) punonjës të certifikuar për testim software.

f. 1 (një) punonjës të certifikuar për administrim database.

g. 1 (një) punonjës të certifikuar për siguri në rrjet.

Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- *Diplomat ose vërtetime nga universitetet përkatëse.*
- *Certifikata përkatëse*
- *Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B;*
 - *Listëpagesat sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B.*

Operatori ekonomik “iCom” sh.p.k nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përmbushjen e kriterit 2.3.3.

KVO konstaton se operatori ekonomik “iCom” Sh.p.k nuk ka përmbushur kriterin 1.b/c/d/dh/e/f/g/h/i si pjesë e kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, kriterin 1, dhe kriterin 2.1 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë, kriterin 2.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, kriteret 2.2.1, 2.2.2, dhe kriteret 2.3.1, 2.3.2, 2.3.3, 2. të kapacitetit teknik dhe profesional, si pjesë e kritereve të vecanta të kualifikimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“COMMUNICATION PROGRESS” shpk**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1.368.000 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë pa tvsh është identifikuar si Oferta e Suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.